

**VENDIM**  
**Nr.987, datë 1.12.2010**

**PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**PËR QEVERINË AFGANE, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT**  
**NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.200 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie, pa shpërblim, të 30 000 (tridhjetë mijë) automatikëve 7.62 mm, model 56, dhe të 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) fishekëve 7.62 mm, model 56, Qeverisë Afgane, për Policinë Kombëtare Afgane, si kontribut i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**